



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.1552/23

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Turkiye Isbankasi A.S – Dega në Kosovë, të cilin me autorizim e përfaqëson M.H., nga Prishtina, Rr. “Mehmet Bushi”, ZP H-6, nr.5, kundër debitorëve 1.Kosova Reisen SH.A, me seli në Gjakovë, dhe 2.B.S., nga Gjakova, Rr. “Elton Zherka”, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Editon Osmani, nga Prishtina, Rr. “Sylejmani Vokshi”, H-19, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.150/20 të datës 23.11.2020, me datën 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorëve 1.Kosova Reisen SH.A, me seli në Gjakovë, dhe 2.B.S., nga Gjakova, Rr. “Elton Zherka”, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Editon Osmani, nga Prishtina, Rr. “Sylejmani Vokshi”, H-19, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.150/20 i datës 23.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.150/20 të datës 23.11.2020, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar propozimin për kthim në gjendje të mëparshme të debitorëve Kosova Reisen SH.A, me seli në Gjakovë dhe B.S., nga Gjakova, në lëndën P.nr.88/20 të datës 29.01.2020, me të cilin është lejuar përmbartimi, ashtu që ka lejuar prapësimin e debitorëve të përmbartimit të datës 13.07.2020 si të afatshëm. Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër urdhrit të përmbartuesit privat PP.nr.88/20 të datës 29.01.2020 si të pa bazuar. Kurse në pikën III të dispozitivit ka vendosur që, ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor përfaqësuesi i autorizuar i debitorëve, avokat Edition Osmani, nga Prishtina, ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të se drejtës materiale, me propozimin që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, të prishet aktvendimi PPP.nr.150/20 i datës 23.11.2020 i Gjykatës Themelore në Gjakovë,

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallë të parë, si dhe të obligohet kreditori ti kompensoj debitorëve shumën prej 633,75 € në emër të përpilimit të kësaj ankese nga avokati sipas tarifave të OAK-së.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që ankesa e debitorëve të refuzohet si e pa bazuar, ashtu që të vërtetohet aktvendimi PPP.nr.150/20 i datës 23.11.2020 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarrimor P.nr.88/20 i datës 29.01.2020.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datë 28.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbarrimor, Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr.841/2018 REF.nr.104/18, vlera e përmbarrimit 147,326.47 €, si dhe kamatat dhe shpenzimet procedurale.

Përmbarruesi Privat Valdrin Beka, nga Prishtina me urdhrin përmbarrimor PP.nr.88/20 të datës 29.01.2020, e ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrimor - Kontratës mbi Hipotekën LRP.nr.841/2018 REF.nr.104/18, sipas propozimit të lartcekur.

Përfaqësuesi i autorizuar i debitorëve me datën 23.07.2020 ka paraqitur kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme, duke theksuar se debitorët pasi janë informuar përmes telefonit nga Zyra Përmbarrimore për procedurën e hapur përmbarrimore ndaj tyre (për shkak se aktualisht jetojnë në Zvicër), më kanë autorizuar që të ndjek procedurat e parapa ligjore dhe me datën 20.07.2020 kam pranuar fizikisht propozimin për përmbarrim dhe urdhrin për përmbarrim PP.nr.88/20 të datës 29.01.2020 nga Zyra Përmbarrimore VAIS LAË. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme si e bazuar, dhe të anulohen veprimet e ndërmarra nga Zyra Përmbarrimore, ashtu që tu jepet mundësia debitorëve që të realizojnë të drejtat e tyre në procedurë.

Kërkesës për kthimin në gjendjen e mëparshme i'a ka bashkangjitur edhe mjetin e rregullt juridik, përkatësisht prapësimin, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet prapësimi i debitorëve si i bazuar, të anulohet ose shfuqizohet urdhri për përmbarrim P.nr.88/20 i datës 29.01.2020, si dhe të obligohet kreditori që t'ua kompensojë debitorëve shumën prej 633.75 € në emër të përpilimit të këtij prapësimi nga avokati sipas tarifave të OAK-së.

Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, pas shqyrtimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.150/20 të datës 23.11.2020, e ka aprovuar si të bazuar propozimin për kthim në gjendje të mëparshme të debitorëve Kosova Reisen SH.A, me seli në Gjakovë dhe B.S., nga Gjakova, në lëndën P.nr.88/20 të datës 29.01.2020, me të cilin është lejuar përmbarrimi, ashtu që ka lejuar prapësimin e debitorëve të përmbarrimit të datës

13.07.2020 si të afatshëm, ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër urdhrit të përbaruesit privat PP.nr.88/20 të datës 29.01.2020 si të pa bazuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se debitorët pretendimet e tyre nuk i kanë mbështetur në prova në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP-së, si dhe ka theksuar se kreditori propozimin për përbarim e ka ushtruar në afatin e caktuar, të cilit propozim i'a ka bashkangjitur Kontratën mbi Hipotekën LRP.nr.841/2018 REF.nr.104/18 të vërtetuar pranë Noterë Flutur Zajmi dhe e regjistruar në Librat Kadastral sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës nr.323/18 të datës 27.02.2018. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përbarimore, ngase me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se “*Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 22 par 1. nën par.1.7 të LPP-së përcaktohet se “*1. Dokumente përbaruese janë: 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*”. Gjithashtu me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “*Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, e në rastin konkret dokumenti përbarimor përmban tiparet e nevojshme të përbarueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përbarimore, ndërsa debitori ne prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 te LPP-së.

Prandaj, kjo gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve, për arsye Kontrata mbi Hipotekën LRP.nr.841/2018 REF.nr.104/18, e regjistruar në Librat Kadastral sipas Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës nr.323/18 të datës 27.02.2018, siç vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës përmban të gjitha elementet e nevojshme për t'u cilësuar si dokument i përbarimor sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar edhe kur ka vendosur kur ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktvendimit kur e ka shqyrtuar kërkesën për kthim ne gjendje te mëparshme dhe pas vlerësimit të shkresave te lendes ka konstatuar se kërkesa ishte e bazuar andaj edhe me të drejte e ka aprovuar dhe e ka lejuar kthimin ne gjendje te

mëparshme duke i lejuar debitorëve Kosova Reisen SH.A, me seli ne Gjakove, i përfaqësuar nga R.S. dhe B.S. qe te dy nga Gjakova, dhe B.S., nga Gjakova, rr." "Elton Zherka, parashtrimin e prapësimit si të afatshëm ne lëndën P.nr.88/20 te datës 29.01.2020 me te cilin është lejuar përmbarimi sepse në këtë drejt gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh faktin se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 129 te LPK, lidhur me nenin 17 te LPP-se, me të drejt e ka aprovuar kërkesën e debitorëve si te bazuar dhe ka vendosur si ne dispozitiv nën I të aktvendimit.

Duke u mbështetur ne nenin 69 par.4 te LPP *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitorët nuk kanë ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorëve në prapësim.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marrë parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorëve të ushtruar kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, P.nr.88/20 të dt.29.01.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1552/23, me datën 13.05.2024

Gj y q t a r i,
Faton Bajrami